



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 6652 Prot.

Tiranë, më: 16.07.2019

URDHËR

Nr. 252, Datë 16.07.2019

“PËR

MIRATIMIN E PROJEKTEVE TURISTIKE QË PËRFITOJNË MBËSHTETJE
FINANCIARE NGA BUXHETI I SHTETIT”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 31 të Ligjit nr. 93/2015, datë 27.07.2015, “Për turizmin”, i ndryshuar, të pikës 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016, "Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në turizëm”, me propozim të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve,

URDHËROJ:

1. Miratimin e projekteve turistike, të kualifikuara nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, si më poshtë vijon:

- a. “Në udhëtim me Edward Lear në Shqipëri”
- b. “#Festivali i Traditës”
- c. “Promovimi i Kulturës dhe Traditës Shqiptare”

2. Ngarkohet Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, për publikimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të listës së projekteve përfituese të financimit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.


MINISTRI
BLENDI KLOSI